



Udhëzues për dorëzimin e propozimeve për projekte

Thirrje për propozime për iniciativa
në kuadër të projektit

Mbështetja për Organizatat Lokale të Shoqërisë Civile - nismat e Drejtësisë Tranzicionale
dhe për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor - Rrjeti i Pajtimit i KOMRA -s,
Europe Aid/168130/DH/ACT/Multi

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve: 16 tetor, 2021.



Co-funded by
the European Union



Rockefeller
Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World



Ministry of Foreign Affairs
of the Czech Republic

PËRMBAJTJA

1. Rrjeti i pajtimit KOMRA	1
1.1. Konteksti	1
1.2. Qëllimet	2
1.3. Korniza financiare	3
2. KRITERET PËR PJESEMARRJE	3
2.1. Bartësit e aplikacioneve	3
2.2. Aktivitete	4
3. MËNYRA E APLIKIMIT	6
3.1. Përmbajtja e aplikacionit	6
3.3. Afati i aplikimit	7
3.4. Pyetje lidhur me Thirrjen	7
4. EVALUIMI DHE PËRZGJEDHJA	8
4.1. Tabela për evaluimin e propozimeve të projekteve	8
5. NJOFTIMI MBI VENDIMIN	8
6. KORNIZAT E AFATEVE	9

1. Rrjeti i pajtimit KOMRA

1.1. Konteksti

Rrjeti i pajtimit KOMRA (RRPK), ish Koalicioni për KOMRA-n, i tubon organizatat e shoqërisë civile, artistët e shquar, shkrimtarët, historianët dhe juristët, të cilët e përfaqësojnë pikëpamjen se regjistri emër për emër i të gjitha viktimave të luftërave të viteve 1991-2001 në hapësirën e ish Jugosllavisë është kusht i pajtimit dhe garanci e mospërsëritjes së luftërave dhe krimeve. Përkrahjen për regjistrin rajonal të viktimave të luftës e kanë dhënë 580.000 qytetarë të vendeve post-jugosllave, të cilët në vitin 2011 e kanë nënshkruar petitionin për themelimin e KOMRA-s. Deri në vitin 2015, liderët e Serbisë, Kroacisë, dy anëtarë të Presidencës së B dhe H, të Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë (Maqedonisë Veriore të tashme) e kanë mbështetur nismën qytetare që shtetet bashkërisht të regjistrojnë të gjitha viktimat e luftës. Koalicioni për KOMRA-n në muajin dhjetor të vitit 2014 e ka miratuar Projekt Statutin e KOMRA-s, të cilin paraprakisht e kanë përgatitur të dërguarit e liderëve të vendeve të cekura dhe ekspertët e Koalicionit për KOMRA-n si dokument për fillimin e procedurës për themelimin e KOMRA-s. Në muajin shkurt të vitit 2015, në zgjedhjet presidenciale në Kroaci ka fituar Kolinda Grabar-Kitarović, e cila nuk e ka përkrahur pjesëmarrjen e Kroacisë në ballafaqimin rajonal me të kaluarën. Në pajtim me marrëveshjen me liderët e vendeve të tjera post-jugosllave, Koalicioni e ka përgatitur Deklaratën për themelimin e KOMRA-s, me propozimin që në samitin e Procesit të Berlinit në Londër në vitin 2018 ta nënshkruajnë ministrat e punëve të jashtme të Ballkanit Perëndimor, duke pritur që Kroacia, si anëtare e BE-së, do të inkuadrohet më vonë. Megjithatë, vendimin e qeverisë për nënshkrimin e Deklaratës e ka sjellë vetëm Mali i Zi, arsye kjo përse nënshkrimi i Deklaratës është hequr nga rendi i ditës së samitit të Procesit të Berlinit në vitin 2018. Në kuadër të përgatitjeve për samitin e Procesit të Berlinit në vitin 2019, drejtori gjeneral i nderit i KE, Pierre Mirel, në emër të Drejtorisë së BE-së për politikë të fqinjësisë dhe negociatave për zgjerim e ka vizituar Sarajevën dhe në takimet me këshilltarët e anëtarëve të Presidencës së B dhe H është informuar se anëtari boshnjak dhe kroat i Presidencës konsiderojnë se themelimi i KOMRA-s është nismë e vjetruar, se për B dhe H prioritet janë stabiliteti dhe siguria rajonale dhe se Republika Srpska nuk e mbështet pajtimin në bazë të fakteve gjyqësore, për të cilat angazhohet Koalicioni për KOMRA-n. E ballafaquar me ndërprerjen e mbështetjes politike, Kuvendi i Koalicionit në muajin dhjetor të vitit 2019, në mbledhjen e saj IX-të, e ka sjellë vendimin mbi rekonstruktimin e Nismës KOMRA - marrjen përsipër të brengës për hartimin e regjistrin rajonal të viktimave (130.000), me anë të rritjes së kapaciteteve hulumtuese përmes përfshirjes së fakulteteve të shkencave shoqërore nga Kroacia dhe B dhe H, dhe sigurimin për mjetet përkatëse financiare. Delegatët e kanë sjellë vendimin mbi transformimin e Koalicionit për KOMRA në Rrjetin e Pajtimit KOMRA (RRPK), e cila e

ka për qëllim që të regjistrohen viktimat e luftërave të viteve 90-të, duke u nisur nga faktet mbi viktimat e krimeve të luftës, të cilat i ka vërtetuar Tribunali i Hagës dhe gjykatat vendore si dhe faktet, të cilat i ka mbledhur Koalicioni për KOMRA-n mbi viktimat e luftës në Kroaci dhe në Kosovë.

Sipas të dhënave të RRPK-së, identiteti i të paktën 27,500 viktimave të luftës tashmë është vërtetuar: rreth 7.000 viktima të krimeve të luftës janë vërtetuar me anë të aktgjykimeve gjyqësore, Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) dhe Fondi për të Drejtën Humanitare (FDHK) nga shumë burime e kanë vërtetuar identitetin e 13,500 viktimave civile dhe ushtarake në lidhje me luftën në Kosovë, kurse Documenta dhe FDH e kanë vërtetuar identitetin e rreth 7.000 viktimave civile dhe të luftës në Kroaci. Një pjesë e madhe e punës është kryer, por është më se e nevojshme që sa të jetë e mundur më parë të kryhet regjistrimi i të gjitha viktimave dhe që të dhënat të jenë publikisht të qasshme për verifikim.

Për një punë të këtillë të rëndësishme është thelbësore një mbështetje më e fuqishme për nismat në nivel lokal, të cilat e promovojnë perspektivën e viktimave dhe të drejtësisë, pajtimin rajonal, respektimin e viktimave pa marrë parasysh përkatësinë etnike, e ruajnë kujtimin e të vrarëve, i mësojnë të rinjtë që të mësojnë, të mbajnë mend dhe të mendojnë në mënyrë kritike për të kaluarën. Prej këndej rezulton projekti i granteve të vogla, që i kanë menduar anëtarët e RRPK-së, të cilat marrin pjesë në hulumtimin e humbjeve njerëzore dhe të vendeve të ngujimit – Fondi për të Drejtën Humanitare (Serbi), Fond për të Drejtën Humanitare Kosovë (Kosovë), Shoqata për Drejtësinë Tranzicionale, Pajtimin dhe Përkujtimin në B dhe H dhe Qendra për Demokraci dhe Drejtësi Tranzicionale (B dhe H), Qendra për Edukim Qytetar (Mali i Zi) dhe Instituti për Politikë Evropiane (Maqedonia e Veriut).

1.2. Qëllimet

Qëllimi i përgjithshëm është zhvillimi i rrjetit të shoqërisë civile për pajtimin në hapësirën e ish Jugosllavisë, të vendosur „nga poshtë-lartë“, që i vendos viktimat në plan të parë. Qëllimet specifike janë përforcimi i pozitës dhe i zërit të të rinjve, i grave, i viktimave dhe i organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal në lidhje me pajtimin rajonal dhe këmbimi trans-rajonal i njohurive dhe i praktikave të mira.

Dërgojeni propozimin e nismës, e cila i kontribuon zgjerimit të njohurive mbi faktet gjyqësore dhe përforcimit të zërit të viktimave, pranimit dhe zbulimit të ngjarjeve dhe të krimeve të luftës në bashkësinë lokale, përkujtimin e viktimave dhe pajtimin rajonal. Propozimi i nismës (projektit) nuk duhet të dërgohet në formën finale, sepse janë të parapara punëtori, në të cilat organizata të zgjedhura do të zhvillojnë idetë e tyre. Punëtoritë do të udhëhiqen nga ekspertët për drejtësi tranzicionale dhe zhvillim të

projekteve, me të cilët do të formuloni projektin, planin e veprimit dhe buxhetin. Projektet i miraton ekipi për përzgjedhjen e projekteve, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e organizatave, të cilat marrin pjesë në realizimin e projektit të rrjetave të pajtimit KOMRA.

1.3. Korniza financiare

Shuma e plotë e mjeteve për zbatim deri të 25 projekteve është 125.000 EUR.

Shuma minimale e mjeteve të kërkuara është 2.000 EUR për një projekt.

Shuma maksimale e mjeteve të kërkuara është 7.000 EUR për një projekt.

Dhjetë projekte do të kenë mbështetjen financiare me mjete deri në lartësinë 7.000 EUR, kurse 15 në lartësinë prej 2.000 deri në 5.000 EUR.

Shuma e saktë e mbështetjes financiare për secilin projekt të miratuar do të konfirmohet pasi që Ekipi për përzgjedhjen e projekteve të miratojë planet e veprimit për realizimin e projekteve të miratuara.

2. KRITERET PËR PJESËMARRJE

2.1. Bartësit e aplikacioneve

Për pjesëmarrje mund të aplikojnë organizatat të cilat janë:

- persona juridik të regjistruar në pajtim me rregullat kombëtare në fuqi në Bosnjë e Hercegovinë, në Serbi, në Kosovë ose në Mal të Zi;
- joprofitabile;
- organizata të shoqërisë civile;
- aktive në nivel të bashkësisë lokale;
- disponojnë me kapacitete të mjaftueshme organizative dhe që janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për përgatitjen dhe realizimin e projektit (partner, nëse i ka).

Organizatat, të cilat aplikojnë duhet të plotësojnë kushtet e cekura në mënyrë kumulative.

Organizatat mund të aplikojnë në mënyrë individuale ose me organizata të tjera. Partneritetet dhe rrjetëzimet nuk janë kusht për aplikim.

Partnerët duhet të plotësojnë të njëjtat kushte si edhe organizatat, të cilat i dorëzojnë për propozim të projektit.

Partitë politike, organizatat ndërkombëtare, institucionet qeveritare, bashkësitë fetare dhe organizatat joformale nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje.

Organizatat duhet të kenë përvojë aktiviste në fushën e të drejtave të njeriut dhe/ose drejtësisë tranzicionale. Përparësi kanë organizatat me përvojë në realizimin e aktiviteteve për vendosjen e drejtësisë tranzicionale, projektet, të cilat merren me çështjet gjinore, me të rinjtë ose me viktimat, si dhe projektet, të cilat do të zbatohen në vende më të vogla.

2.2. Aktivitete

Aktivitetet duhet të jenë të drejtuara në fushat ose temat e mëposhtme:

- Promovimi i fakteve të vërtetuara para GJNPJ dhe gjykatave vendore në lidhje me luftërat në hapësirën e ish Jugosllavisë;
- Promovimi i shembujve më pak të njohur të marrëdhënieve konstruktive ndëretnike midis individëve ose bashkësive gjatë kohës së luftës ose në periudhën post-konfliktuale;
- Përparimi i perceptcionit dhe i të kuptuarit të rëndësisë së drejtësisë tranzicionale dhe pajtimit rajonal;
- Monitoringu i politikave të përkujtimit të vendeve post-jugosllave (një ose më shumë), përgatitja dhe avokimi i rekomandimeve për zbatimin e instrumenteve të politikës, të cilat i vendosin viktimat në plan të parë (mësimi i historisë, komemorimi dhe memorializimi, formësimi artistik i narrativave të përkujtimit, me të cilat udhëheq shteti);
- Ligjërimi mbi temat e neglizhuara ose të diskutueshme, të cilat kanë të bëjnë me ballafaqimin me të kaluarën;
- Krijimi i vendimeve për memoriale ose komemoracione, të cilat i përfshijnë të gjitha viktimat, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, me pranim të posaçëm të vuajtjeve të grave dhe të të rinjve;
- Organizimi ngjarjeve komemorative në bashkësitë lokale, të cilat i përfshijnë të gjitha viktimat, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, me pranim të posaçëm të vuajtjeve të grave dhe të të rinjve dhe promovimi i tyre në mediet tradicionale dhe në rrjetet sociale;
- Verifikimi i fakteve (*fact-checking*) në mediet lokale në lidhje me pajtimin, ballafaqimin me të kaluarën, dialogun etj., të cilat i theksojnë gabimet faktografike dhe interpretimet e gabuara – promovimi i fakteve të vërtetuara me anë të gjykatës (në rrjetet shoqërore ose në faqet e internetit);
- Organizimi i ngjarjeve kulturore mbi pajtimin, drejtësinë tranzicionale, gjuhën e urrejtjes; në formën e performansave, ekspozitave (piktura, fotografi, stripa etj.),

shfaqje teatrale, poezisë, kritikës letrare ose teatrale, e cila merret me format e fshehura të stereotipeve etnike e gjinore;

- Programet e këmbimit për të rinjtë, të orientuar nga pajtimi;
- Programet e këmbimit për shoqatat e viktimave;
- Reportazhe dhe intervista të gazetarëve të rinj (deri 35 vjeç), të cilat i paraqesin viktimat ose anëtarët e familjeve të viktimave të përkatësisë tjetër etnike dhe jetën e tyre pas luftës, traumat, humbjen dhe kërkimin për ata të cilët edhe më tutje janë në listën e të zhdukurve;
- Njohja dhe dekonstruktimi i miteve dhe i paragjytimeve (krijimi i tyre dhe ndikimi) mbi bashkësitë e tjera etnike;
- Inicimi i debatit lidhur me njërin prej temave të mëposhtme (lista nuk është përfundimtare):
 - Roli i vendeve post-jugosllave në pajtimin rajonal në lidhje me pozitën e tyre në procesin e pranimin në Bashkimin Evropian;
 - Ndikimi i ndryshimit të pushtetit në vendet post-jugosllave në marrëdhëniet me vendet e tjera të rajonit;
 - Roli i fesë në pajtimin dhe në drejtësinë tranzicionale;
 - Industria e përkujtimit – filmat dhe dramat dokumentare, seritë dhe librat, të cilat janë prezantuar kohët e fundit;
 - Mohimi dhe keqpërdorimi i nocionit të *gjenocidit* në mungesë të rregullativës përkatëse juridike dhe
 - Zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe problemet e parashikueshme të politikës zyrtare të përkujtimit të BE-së në lidhje me vendet post-jugosllave si dhe propozimet për tejkalimin e tyre.

Nga organizatat, të cilat aplikojnë, pritet që në mënyrë të qartë të cekin se në çfarë mënyre do të merren me çështjen gjinore dhe interseksionalitetin (me kombinimin e gjinisë dhe karakteristikat e tjera personale ose të identitetit, siç janë përkatësia etnike, mosha, invaliditeti etj.)

Aktivitetet, të cilat nuk do të merren në shqyrtim:

- mbështetja financiare për individët për pjesëmarrje në punëtoritë, seminarët, konferencat, kongreset;
- stipendimi i individëve për studime, trajnime, vizita studimore ose pjesëmarrje në ngjarjet ndërkombëtare;
- aktivitetet promovuese;
- projektet infrastrukturore ose furnizimi me pajisje;
- blerja dhe/ose renovimi i objekteve ose i zyrave;
- aktivitetet e realizuara para nënshkrimit të kontratës;
- aktivitetet që e kanë për synim përfitimin;
- donacionet dhe ndihma humanitare;

- aktivitetet, të cilat tashmë janë mbështetur në kuadër të programeve të tjera të BE-së;
- kërkesat për bashkëfinancim.

Përparësi do të kenë aktivitetet, me zbatimin e të cilave realizohen rezultate të dukshme me ndikim afatgjatë, si dhe ato, të cilat ofrojnë qasje origjinale dhe pranuese, duke përfshirë edhe zgjidhjet digjitale.

Kohëzgjatja

Aktivitetet mund të kryhen nga shkurti deri në fund të tetorit 2022.

Lokacioni

Organizatave, të cilave iu janë miratuar projektet, aktivitetet i realizojnë në shtetin ku ndodhen. Pos kësaj, aktivitetet mund të zhvillohen në një ose më shumë shtete të përfshira në Thirrje – në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Serbi, në Kosovë, në Mal të Zi dhe/ ose në Maqedoni.

Numri i propozimeve të projektit dhe i granteve për organizatë

Organizata nuk mund të aplikojë për më shumë se me një propozim të projektit në kuadër të Thirrjes.

Partneri nuk mund të aplikojë më shumë se një propozim të projektit në kuadër të kësaj Thirrjeje.

3. MËNYRA E APLIKIMIT

3.1. Përmbajtja e aplikacionit

Propozimet e projekteve duhet të jenë në gjuhën angleze ose në gjuhën zyrtare të ndonjërit prej vendeve të përfshirë me anë të Thirrjes.

Aplikacionin e përbëjnë:

- Formulari i plotësuar i aplikacionit, në të cilin ceket edhe shuma kornizë për realizim, e cila mund të lëvizë deri në 20% në lidhje me shumën përfundimtare të miratuar;
- Certifikata e skanuar mbi regjistrimin, e lëshuar nga ana e institucionit kompetent.

3.2. Si të aplikohet

Aplikimet dërgohen në mënyrë elektronike në regional@recom.link, me titull (subject): Propozimi i projektit në kuadër të thirrjes *Përkrahja për organizatat lokale të shoqërisë civile në nismat e drejtësisë tranzicionale dhe ndërtimi i besimit në Ballkanin Perëndimor – Rrjeti i pajtimit KOMRA (Europe Aid/168130/DH/ACT/Multi)*. Pas dorëzimit të aplikacionit, do të verifikohet pranimi i tij. Aplikacionet jo të plota nuk do të shqyrtohen.

3.3. Afati i aplikimit

Afati i fundit për aplikim është 16 tetor, 2021. Iu lutemi të interesuarve që të kenë parasysh problemet e mundshme teknike dhe që propozimet e projekteve të mos i dërgojnë në momentin e fundit.

3.4. Pyetje lidhur me Thirrjen

Pyetjet të dërgohen në mënyrë elektronike në regional@recom.link, më së voni deri në datën 25 shtator të vitit 2021.

Ekipi për përzgjedhje të projekteve nuk do t'iu përgjigjet pyetjeve, të cilat arrijnë pas datës së cekur.

Në të gjitha pyetjet e dërguara me kohë, Ekipi përgjigjet më së voni në datën 5 tetor të vitit 2021.

Të gjitha pyetjet, përgjigjet, por edhe njoftime të rëndësishme gjatë kohës së procesit të përzgjedhjes, do të publikohen në webfaqen e Rrjetit të Pajtimit KOMRA.

I rekomandojmë të gjithë kandidatëve që rregullisht të vizitojnë webfaqen, në mënyrë që të jenë në rrjedha.

4. EVALUIMI DHE PËRZGJEDHJA

Aplikacionet do t'i kontrolloj dhe vlerësoj Ekipi për përzgjedhje, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e organizatave partnere, duke i ndjekur hapat dhe kriteret e caktuara: në fazën e parë, do ta bëjë verifikimin administrativ të dokumentacionit, i cili kërkohet me anë të Thirrjes. Vetëm aplikacionet e plota, të cilat i plotësojnë kriteret e cekura, do të kalojnë në fazën e dytë të evaluimit. Në fazën e dytë, evaluimi do të bëhet sipas tabelës së bashkëngjitur.

4.1. Tabela për evaluimin e propozimeve të projekteve

Kriteret	Numri maksimal i pikëve
Kapacitet operative	
A ka(në) kandidati(ët) përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve?	5
A ka(në) kandidati(ët) përvojë me projektet në fushën e pajtimit?	5
Relevanca	
Sa është projekti relevant për pajtimin rajonal?	10
Sa është projekti relevant për këtë Thirrje?	10
A janë të përkufizuara në mënyrë precize grupet e synuara (targetuara) dhe nevojat e tyre?	10
Koncepti i propozimit të projektit	
A i përgjigjet qëllimi i projektit problemit, i cili është i identifikuar?	5
A i kontribuojnë rezultatet e pritura të aktivitetit realizimit të qëllimit të projektit?	5

5. NJOFTIMI MBI VENDIMIN

Në pajtim me kornizat e afateve, vendimi përfundimtar do të merret në datën 10 nëntor të vitit 2021. Të gjithë kandidatët do të njoftohen në formën me shkrim për vendimin e Ekipit për Përzgjedhje, që kanë të bëjnë me aplikacionin e tyre dhe, nëse janë të refuzuar, mbi arsyet e një vendimi të tillë.

6. KORNIZAT E AFATEVE

	Data
1. Afati i fundit për parashtrimin e pyetjeve	25 shtator, 2021.
2. Dita e fundit për përgjigje/sqarime	5 tetor, 2021.
3. Afati i aplikimit	16 tetor, 2021.
4. Njoftimi për vendimin përfundimtar	12 nëntor, 2021.
5. Punëtori për zhvillimin e iniciativave të përzgjedhura të projektit dhe shkrimin e një draft Plani të Veprimit për zbatimin e projektit dhe buxhetin e projektit	10 dhjetor, 2021
6. Nënshkrimi i kontratës	1 shkurt, 2022.